

UDHËZIM
Nr. 6/1, datë 17.3.2014

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHITUAR”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shituar”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në”, të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1.1., germa “b”, fjalia e fundit, fjalët “si paguese e taksës vendore të biznesit të vogël” zëvendësohet me fjalët “paguese e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.

2. Në pikën 8, fjalia e fundit e paragrafit ndryshon, me këtë përmbajtje:

“Në të njëjtën kohë, nenet 20, 21, 22, 23, 24, 24/1, 25, 25/2, 25/3, 25/5, 25/6, 25/7, 25/8, 25/9, 25/10, 25/11 dhe 26/1 të ligjit, parashikojnë edhe përjashtimet nga ky tatim.”.

3. Pika 8.7 “Operacionet hidrokarbure” shfuqizohet.

4. Pika 8.8.2 ndryshon në përmbajtje, si më poshtë:

“8.8.2 Furnizimi i barnave dhe shërbimeve shëndetësore

Që prej datës 1 prill 2014, furnizimi i barnave, shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Në kuptim të kësaj pike, me barna kuptohen barnat për konsum njerëzor dhe barnat që përdoren për kafshët.”.

5. Pika 8.8.2.1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“ 8.8.2.1 Për barnat e importuara dhe të prodhuara në vend, të pajisura me pullën e kontrollit me çmimin me TVSH 10%, me qëllim për t’u tregtuar (shitur) që rezultojnë gjendje në subjektet farmaceutike deri në datën 1 prill 2014, do të aplikohet TVSH-ja në shitje siç rezulton e shënuar në pullë.

Të gjitha pullat e kontrollit të barnave që shiten nga data 1 prill 2014, nuk do të kenë të përfshirë TVSH-në në çmimin përfundimtar të shitjes.

Qendra e Kontrollit të Barnave merr masa që në pullën e kontrollit të barnave të evidentohet çmimi përfundimtar pa TVSH.

Gjatë muajit prill 2014, çdo person juridik apo fizik, importues, prodhues apo tregtar i barnave, do të deklarojë stokun e barnave deri në datën 31.3.2014 në organin tatimor ku është i regjistruar.”.

6. Paragrafi i parë i pikës 8.8.2.2 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Që prej datës 1 prill 2014, furnizimi i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, që kanë karakter terapeutik, si dhe të domosdoshëm për arritjen e qëllimeve terapeutike të synuara nga hospitalizimi dhe kujdesi mjekësor ndaj shtetasve, janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani